

Ndikimi i COVID-19 në qeverisje dhe mbikqyrjen demokratike

Policy Brief

Nëntor 2020

**Rastet e Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut
Nga Qendra Europiane për Studimin e Sigurisë**
(Redaktor, Jos Boonstra)

Hyrje

Pandemia e Covid-19 ka ndikuar ndjeshëm në vendet e Ballkanit Perëndimor. Pandemia ka rrezikuar jo vetëm shëndetin dhe mirëqënien e qytetarëve të këtyre vendeve (gjë që vazhdon ta bëjë akoma), por ka vënë në sprovë edhe qëndrueshmërinë e institucioneve të reja demokratike në këto vende. Sikursë në rajonet e tjera të botës, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë ndërmarrë masa kufizuese në mungesë të mbikqyrjës së duhur nga Kuvendi apo aktor të tjerë demokratik. Në disa vende, qeveritë vendase kanë keqpërdorur pushtetin e tyre të pakontrolluar për të përshpejtuar kalimin e ligjeve jo-demokratike apo për të konsoliduar edhe më tej tendencat autoritare. Në disa vende të tjera, institucionet që ushtrojnë mbikqyrje kanë rifituar pushtetin e tyre për të mbajtur qeverinë në kontroll.

Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut reflektojnë një panorama përgjithësisht të njëjtte në te trija vendet. Premtuës është fakti që institucionet demokratike, pavarësisht se të pakonsoliduar, kanë dëshmuar se janë mjaftueshëm të qëndrueshme për t'i bërë ballë sfidave që rrjedhin nga mbylljet dhe gjendja e emergjencës. Sistemi nuk u cenua, sundimi i ligjit mbizotëroj përgjithësisht, dhe qeveritë në të shumtën e rasteve vepruan me qëllimin e mire për të garantuar sigurinë e qytetarëve të tyre janë shënja të mira. Por lajm të keq përbën fakti që praktikat ditore të mbikqyrjes demokratike nga parlamentit dhe institucionet e tjera – gjë e cila ishte problematike edhe përpara pandemisë – është dobësuar akoma më shumë, përfshi edhe në disa raste ku ka munguar plotësisht, si në rastin e mbikqyrjës sesi është përdorur fondi për zhvillimin e bashkëpunimit të jashtëm nga qeveria.

Pikët kryesore:

- Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut kanë ndërmarrë masa të ashpëra kufizuese që lidhen me sigurinë, të cilat janë pranuar përgjithësisht nga qytetarët e këtyre vendeve pasi ishin të vetëdijshëm për gjendjen e dobët të sistemit shëndetsor në vendet e tyre.
- Masat e qeverisë në luftën kundër Covid-19 dhe mbikqyrjës janë ndëlikuar nga trazirat politike: Mungesa e partive opozitare në Kuvendin e Shqipërisë; Kabineti me probleme i Kosovës, i cili u rrëzua si rrjedhojë e masave për të luftuar Covid-19; dhe Maqedonia e Veriut e cila ishte në periudhë zgjedhjesh parlamentare.
- Te trija vendet duhet të shqyrtojnë si të përparojnë në ndërtimin dhe konsolidimin e institucioneve demokratike, pasi kriza zbuloi dukshëm brishtësinë e tyre por edhe aftësinë e tyre për të funksionuar në rrethana të vështira.

Ky policy brief shqyrton qeverisjen demokratike në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, si dhe vlerëson qëndrueshmërinë e institucioneve demokratike për të përmbushur funksionin e tyre të mbikqyrjes së qeverisë gjatë mbylljes. Ky punim është fryt i një pune bashkëpunuese mes punonjësve të administratës dhe aktorëve të shoqërisë civile nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut në kuadrin e projektit të DECOS. Ekspertët e mëposhtëm kanë ofruar pikëpamjet e tyre dhe të dhëna lidhur me statusin e mbikqyrjes demokratike gjatë pandemisë së Covid-19 nepërmjet një sërë debatesh online dhe kontributeve me shkrim: Zare Aliu, Hana Bajraktari, Jos Boonstra, Slavica Dimitrievska, Merijn Hartog, Aleksandra Jovevska Gjorgjevikj, Aleksandar Nikolov, Lulzim Peci, Erind Pirani, Alfonc Rakaj, Enea Shehaj, Aleksandar Stojanovski, Besa Tauzi, and Blend Zyrapi. Ky policy brief ofron një pasqyrim të shkurtër të funksionimit të demokracisë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut nën presionin e sfidave që rrjedhin nga pandemia, dhe ofron ide për forcimin e mekanizmave të mbikqyrjes në kohë sfiduese.

Zhvendosja e ndikimit

Një ndër zhvillimet kyçe gjatë pandemisë së Covid-19 është zhvendosja e nivelit të ndikimit dhe pushtetit mes ekzekutivit, legjislativit dhe sistemit të drejtësisë. Në përgjithësi, pushteti ekzekutiv u zgjërua pasi qeveritë përkatëse u dëturuan të vepronin me nxitim për të ndaluar përhapjen e virusit. Por ka prej atyre që në Shqipëri argumentojnë se kjo u përkthye në abuzim të pushtetit, si për shëmbull, hapat e ndërmarrë për ndryshimin e kushtetuese mbi zgjedhjet. Njëkohësisht, palë të tjera shohin bojkotin e kuvendit nga opozita si shkakun kryesor të këtyre zhvillimeve. Në Kosovë, mosmarrëveshjet politike mbi shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme dominuan debatin politik, duke rritur paqartësitë lidhur me politikat që mund të ndërmerre qeveria e formuar rreth një muaj përpara mbylljes. Ndërsa në Maqedoninë e Veriut, vendi u drejtua nga qeveria teknike, gjë që uli rrishtun e keqpërdorimit të pushtetit nga autoritetet qëndrore.

Natyrshtëm, një zhvendosje e tillë pushtetit te ekzekutivit mund të pritët që të realizohet në dëm të legjislativit. Megjithatë, ky nuk është rasti në Shqipëri, ku Kuvendi ishte i dobësuar si mungesa e opozitës. Për rrjedhojë, ai vazhdon të veprojë si firmëtare e politikave të qeverisë. Në Kosovë, mungesa e shumicës qeverisëse çoi në seanca parlamentare të shpeshta, por pa rezultate konkrete. Kuvendi i Maqedonisë ishte kryesisht jashtë ndikimit – ndërsa qeveria teknike menaxhoi mbylljen – kurse zgjedhjet e parakohshme të planifikuara për tu mbajtur në prill 2020 u shtynë për në korrik.

Rreth DECOS

Projekti për 'Zhvillimin e Kapaciteteve, Bashkëpunimit dhe Kulturës së Mbikqyrjes së Sektorit të Sigurisë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut' (2019-22) synon të fuqizojë institucionet dhe aktorët demokratik në funksionin e tyre për të ofruar mbikqyrje demokratike. Këtë synon ta arrijë duke rritur kapacitetet, përmirësuar bashkëveprimin dhe duke nxitur kulturën e mbikqyrjes së sektorit të sigurisë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. DECOS përfshin një component mbi rritjen e kapaciteteve dhe një mbi kërkimin, te dyja të përqendruara te aktorët që ushtrojnë mbikqyrje demokratike – kuvendi, institucionet e pavarura dhe këshilluese; si dhe organizata të shoqërisë civile – në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

Si rrjedhojë e pandemisë së Covid-19, pjesa dërrmuese e kërkimeve dhe trajnimeve të DECOS janë duke u realizuar online në formatin ndërveprues ku marrin pjesë grupe pune nga rajoni dhe përfshin leksione, sesione trajnimi dhe mundësi debati dhe shkëmbimi të ideve dhe përvojave përkatëse.

Në sajë të këtij projekti, Qendra Europiane për Studime të Sigurisë bashkëpunon me Institutin për Studime Politike, Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim nga Shqipëria, Institutin Kosovar për Kërkimin dhe Zhvillimin e Politikave, si dhe me Institutin për Demokraci 'Societas Civilis' nga Maqedonia e Veriut. DECOS mbështetet financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Hollandës.

Panorama e drejtësisë në të tre vendet është pak më e larmishme. Në Shqipëri, sistemi i drejtësisë është nën ndryshimin e rrënjësishëm të procesit reformues për të përmbushur kushtet e Bashkimit Europian (BE). Gjykatat qëndruan të mbyllura deri në fund të muajit maj. Sistemi gjyqësor në Kosovë ishte aktiv në të gjitha nivelet e tij – Gjykata Kushtetuese vendosi që kufizimet e qeverisë nuk ishin në përputhje me ligjet në fuqi dhe për rrjedhojë qytetarët mund të kundërshtonin vendimet administrative; sëbashku, të gjitha këto çuan në vonesa të ndjeshme. Ndërsa, gjykatat e Maqedonisë ishin në një situatë të vështirë dhe në nevojë të thellë për reformë, përfshi edhe pastrimin nga korrupsioni. Covid-19 vuri në pah mangësitë e sistemit të drejtësisë, i cili u tregua i paaftë për t'u përballur me një skenar ku dominojnë kufizimet dhe rritja e kërkesave për vendime.

Megjithëse hapësira veprues e institucioneve të pavarura të mbikqyrjes dhe atyre publike ishte e kufizuar rrënjësisht, ato luajtën role të rëndësishme që shpesh rezultuan në rritjen e njohjes së rëndësisë që kanë ato. Kjo është veçanarisht e dukshme për institucionet që merren me shëndetësinë dhe arsimin. Po ashtu, në të trija vendet, institucioni i Avokatit të Popullit vazhdoi të adresojë ankesat e qytetarëve. Shpesh, institucioneve u kërkohej ndërhyrja në rrethana të vështira. Për shëmbull, detyrimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Përsonele u rriten ndjeshëm si rezultat i zhvendosjes së punës së institucioneve, kompanive dhe qytetarëve (vetëm) online.

Segmente të ndryshme të shoqërisë civile u rriten si rezultat i pandemisë. Në Shqipëri, puna e OJQ-ve dhe vullnetarëve ishte rritur ndjeshëm përpara pandemisë nga termeti shkatërrues i nëntorit. Në përgjithësi, në të trija vendet, aktorët e shoqërisë civile që punojnë në fushat sociale, ofrimin e ndihmës në fatkeqësi natyrore dhe ndihmës humanitare kanë luajtur një rol të parësor, përfshi në raste të vecante edhe duke ofruar ndihme aty ku shteti kishte mangësi. Segmentet më aktive të shoqërisë civile u angazhuan akoma edhe më shumë në disa çështje, si protestat kundër shëmbjes së Teatrit Kombëtar në Tiranë deri në përballimin e rritjes së papritur të rasteve të dhunës brenda familjes gjatë mbylljes nga pandemia. Për më tepër, u shfaqën edhe grupe të reja që protestuan kufizimet dhe vaksinimin.

Pjesa analitike e shoqërisë civile, ku përfshihen qytetar të botës akademike dhe think tanks, hasi në vështirësi dhe e pati të vështirë të përgjigjej sfidave. Por pas një periudhe kohe të shkurtë, u përshtat me kushtet e virtualitetit dhe rifilloi të ushtronte funksionin e saj për të vlerësuar në mënyrë kritike politikën dhe shpenzimet e qeverisë gjatë pandemisë së Covid-19. Zhvendosja e zbatimit të aktiviteteve online dhe vonesat në miratimin e fondeve (të reja) nga donatorët ishte një sfidë me vete për shoqërinë civile. Megjithatë, me tu përshtatur me mbajtjen e aktiviteteve online, pjestarë të shoqërisë civile luajtën një rol të rëndësishëm duke ofruar mbikqyrjen e pushtetit, ofruar të dhëna krahasuese dhe vepruar si ndërmjetës mes autoriteteve dhe qytetarëve. Për më tepër, profesionistët e botës së shkencës kanë luajtur një rol të rëndësishëm me ofrimin e shpjegimit të virusit dhe pasojave të tij për popullsinë e gjërë.

Sikurse në shumicën e vendeve të botës, në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, u vu në pah rëndësia e medias së pavarur dhe raportimi i bazuar në fakte. Sipas disa ekspertëve, njësitë mediatike kanë kaluar një periudhë mësimi dhe si rrjedhojë kanë rritur profesionalizmin, ndërsa burime të tjera mediatike janë zbuluar se kanë mungesë të informacionit cilësor dhe raportimit të paanshëm.

Shqipëria

Kur u shfaq Covid-19 në mars, Shqipëria akoma po rimëkëmbej nga termeti shkatërrues që goditi vëndin në fundin e nëntorit të vitit 2019. Me mijëra mbeten të pastreh dhe në rrezik të lartë infektimi. Gjenjda e 'jashtëzakonshme natyrore' e cila lejon qeverinë të kufizojë mes të tjerash të drejtat e njeriut dhe liritë, ishte akoma në fuqi, gjë që u zgjat deri në fund të qershorit nga Kuvendi. Për ti bërë ballë virusit, qeveria mori masa kufizuese, të cilat u zbatuan nga policia dhe forcat e armatosura. Shqipëria mbylli kufijtë tokësor me vendet fqinje dhe kufizojë lëvizjen e qytetarëve nga një qytet në tjetrin. Dy spitale në Tiranë u përcaktuan për t'u shërbyer vetëm pacientëve të infektuar me virusin Korona. Qeveria miratoi dy paketa ndihmëse për bizneset dhe qytetarët e prekur nga Covid-19.

Me kalimin e kohës, qytetarët u bënë gjithnjë e më kritik ndërsa institucionet e mbikqyrjes rifituan disa prej kapaciteteve të mëparshme për të monitoruar politikat dhe shpenzimet e qeverisë. Fatkeqësisht, Kuvendi vazhdoi të kishte boshllëk, pasi dy prej partive kryesore opozitare dorëzuan mandatet e tyre vitin e mëparshëm. Në të ardhmën, rruga do të jetë e vështirë për institucionet e mbikqyrjes në Shqipëri, kryesisht Kuvendin, Avokatin e Popullit dhe Këshilli i Lartë Shtetëror ndërsa përpiqen të rifitojnë ndikimin e tyre në një vënd të prekur nga protestat, termeti dhe Covid-19 brenda një viti. Veçanarisht shqetësuese është mungesa e mbikqyrjes demokratike mbi shpenzimet e qeverisë, të lidhur kryesisht me përdorimin e ndihmave të konsiderueshme ndërkombëtare; ndërsa koha kalon dhe urgjenca e lindur nga krizat e shumfishta zbehet dhe rrezikshmëria për korrupsion rritet. Në këtë rrafsh, shoqëria civile është aktor aktiv që synon të luaj një rol konstruktiv mbikqyrjeje dhe shërben si urë lidhëse mes qeverisë dhe publikut.

Kosova

Kosova formoi qeverinë e re pas zgjedhore në shkurt të 2020-ës, javë përpara se pandemia e Covid-19 të godiste vëndin. Masa strikte u ndërmorën për të kufizuar përhapjen e virusit,

Covid-19 dhe Shoqëria Civile në Kosovë

Shoqëria civile në Kosovë është një aktor i rëndësishëm. Megjithatë, organizatave të shoqërisë civile iu desh të përshtatnin aktivizmin, mbikqyrjen, hulumtimin dhe zbatimin e projekteve. Gjatë Covid-19, OJQ-të kishin akses të kufizuar informacioni, dhe u detyruan të shkëputëshin nga grupet e caktuara që përfaqësojnë dhe aktivitetet e qeverisë. Sikurse në rastin e Kuvendit, kapacitetet e shoqërisë civile për të mbikqyruar masat e ashpra të sigurisë të ndërmarra për të luftuar virusin, ishin të kufizuara.

Shoqëria civile luajti (ose duhet të kishte luajtur në disa raste) një rol shumë të rëndësishëm në mundësimin e aksesit të informacionit dhe në luftimin e informacionit të shumë keqinformues. Gjatë mbylljes, informacioni në gjuhën e minoriteteve jo-madhore që jetojnë në Kosovë ishte i kufizuar (një detyrim kushtetues i Kosovës). Qartazi, kjo ndikoi në sigurinë e këtyre komuniteteve dhe rriti mundësinë e gjobitjes së antarëve të tyre për moszbatimin e rregulloreve anti-Covid. Një numër OJQ-ësh që përfaqësojnë komunitetin Serb në Kosovë, të mbështetura nga homologët e tyre nga komuniteti shqiptar në Kosovë, protestuan kundër mungesës së informacionit, ndërsa OJQ Serbe në Kosovë morën përsipër përkthimin e masave të qeverisë në serbisht dhe i postuan në rrjetet e tyre sociale.

Mungesa e informimit dhe keqinformimi u përhapen me ritme alarmuese me rritjen e disponueshmërisë si për individë ashtu edhe për outlet të medias. Llojet e të dhënave të shpërndara përfshinë zbehjen e rrezikut të infektimit dhe pasojave nga Covid-19, rekomandimin e trajtimeve mjeksore të paverifikuara apo nxitjen e panikut. Qeveria e Kosovës, media, dhe shoqëritë civile ishin kryesisht të heshtura përballë këtij fenomeni i cili rrezikoi (dhe vazhdon ta bëjë) sigurinë e segmenteve të ndryshme shoqërore. Shoqëria civile duhet të punojë ngushtë me autoritetet për të hartuar dhe zbatuar mekanizmat e duhur për të luftuar keqinformimin dhe mungesën e informacionit.

megjithse të tilla masa acaruan marrëdhëniet mes Presidentit Hashim Thaçi dhe Kryeministrit Albin Kurti, përfshi edhe mbi deklarinim e gjendjes emergjente. Nga fundi i marsit, kabineti i qeverisë Kurti u rrëzua nga një mocion mosbesimi në kuvend. Më herët, në mesin e marsit, qeveria kishte përcaktuar një fond prej 10 milion eurosh për të financuar masat për parandalimin e përhapjes së virusit dhe sistemin shëndetsor. Nga fundi i të njëjtit muaj, qeveria e kthyer në një qeveri kujdestare, njoftoi përcaktimin e një pakete prej 170 milion eurosh për të ndihmuar bashkitë, bizneset dhe individët e prekur nga pandemia. Në fillim të qershorit në kuvend u formua një kabinet i ri qeveritar i kryesuar nga Avdullah Hoti (duke menjanuar zgjedhjet e parakohshme).

Kuvendi vazhdoi të funksionojë edhe gjatë krizës, megjithse më i ngadaltë në veprimet e tij. Qeveria aktuale nuk gëzon një shumicë në numra, gjë që vështirëson qeverisjen dhe rolin ndikues të kuvendit. Institucionet mbikqyrëse të Kosovës ishin aktive gjatë pandemisë, ku aktor si Avokati i Popullit vazhdoi të adresonte çështje të shumta, pavarsisht se ishte vetë në process tranzicioni përfshi edhe ndryshimin e kryesisë. Fakti që themeli i institucioneve të Kosovës është relativisht i ri, pasi shumë prej tyre janë themeluar pas shpalljes së pavarësisë, ka ndikuar pozitivisht në aftësinë e tyre për tu përballur me anomalinë e të punuarit online.

Maqedonia e Veriut

Qeveria e Maqedonisë së Veriut shpalli gjëndjen e jashtëzakonshme, e cila mbeti në fuqi deri në fund të qershorit. Zgjedhjet parlamentare, të cilat fillimisht u planifikuan për në tetor të 2020-ës, u zhvendosën për në prill, dhe pastaj u shtynë për në korrik si pasojë e pandemisë. Gjatë krizës e cila zgjati nga pranvera deri në fillim të verës, Maqedonia e Veriut u udhëhoq nga një qeveri teknike. Një plan me tre hapa u hartua për t'i bërë ballë virusit; së pari, u vendosen kufizime të cilat gjithësesi lejuan mbarëvajtjen e aktiviteteve themeltare ekonomike; së dyti, u lejau kthimi në punë por në zbatim rigoroz të protokolleve shëndetsore; dhe së treti, një rikthim i plotë në vendet e punës. Gjithësesi, kjo nuk mjaftoi dhe vendi u ndikua ndjeshëm nga virusi pasi vendi arriti kulmin e nivelit të infektiveve në fillim të verës.

Mbikqyrja demokratike e vendimeve dhe shpenzimeve qeveritare mori një rëndësi dytësore gjatë muajve të parë të pandemisë. Megjithëse kjo ndodhi për arsye kryesisht teknike, ajo u ndikua edhe nga fakti që qeveria teknike gëzoi mbështetje të gjërë, gjë që ndikoi në zhvendosjen e vëmendjes nga nevoja për të mbikqyrrur Kuvendin dhe institucionet e tjera. Gjithashtu, ky proces nuk u ndihmua as nga mbajtja e zgjedhjeve në mesin e pandemisë dhe krizës shëndetsore që e shoqërojë atë, pasi fushata elektorale pengoi fushatën e mesazheve kundër covid-19. Sëbashku, këta faktor ndikuan negativisht në përceptimin e publikut mbi masat e qeverisë për t'u përballur me krizën.

Rruga përpara

Në vitin e ardhshëm, disa masa lehtësisht të adoptueshme duhet të ndihmojnë në rikthimin e mbikqyrjes demokratike të qeverisë online (masë afatshkurtër). Në 2-3 vitet e ardhshme, te tria vendet duhet të analizojnë në thellësi krizën dhe të veprojnë në mënyrë vendimtare në përgjigje të mangësive të evidentuara (masë afatshkurtër). Dhe në 4-7 vitet e ardhshme, puna duhet të përqëndrohet në forcimin e mëtejshëm dhe konsolidimin e reformave demokratike në dobi të integritimit evropian (masa afat-gjata). Më poshtë mund të gjeni një listë me ide konkrete për politikëbërësit dhe aktorët e shoqërisë civile:

Afat shkurtër

- Zhvillimin e mekanizmave dhe procedurave të sigurta dhe të lehta për tu përdorur online për Kuvendin dhe institucionet e pavarura. Menjano vartësinë e plotë në këto mekanizma pasi procedurat dhe takimet në person do të mundësohen sërish në të ardhmen.
- Mundësimin e kryerjes pjesërore të punës nga shtëpia për stafin e Kuvendit, Avokatit të Popullit, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Përsonele, Këshillit të Lartë shtetëror. Në këtë drejtim, organizatat e shoqërisë civile mund të shërbejnë si shëmbull, pavarisht se kanë më pak të dhëna për të mbrojtur dhe procedura për të ndjekur.
- Lehtësimin e aksesimit të informacionit të disponueshëm në gjuhët të ndryshme, përfshi gjuhë minoritare dhe gjuhën e shenjave.

Afat mesëm

- Përfshirja e akademive, think tanks dhe OJQ-ve në vlerësimin e masave të autoriteteve për të parandaluar përhapjen e Covid-19. Cfare funksionojë mire dhe cfare jo? Si mund të mbahen të informuara institucionet mbikqyrëse në një krizë të ngjashme në të ardhmën?
- Në të njëjtën linjë veprimi, të vlerësohet roli i medias (online) dhe të hartohet një strategji e mbështetur gjërësisht për t'iu kundërvënë mungesës së informacionit dhe keqinformimit.

Covid-19 dhe Avokati i Popullit

Gjatë mbylljes, Avokati i Popullit në Maqedoninë e Veriut arriti të adresonte pjesën dermuese të kërkesave të qytetarëve. Megjithatë, institucioni i Avokatit të Popullit nuk është konsultuar nga qeveria gjatë mbylljes. Kjo është diçka e pavend pasi ky institucion mund të kishte ofruar rekomandime të dobishme për të mbrojtur më mire të drejtat e njeriut gjatë periudhë kufizuese.

Pas një periudhe tranzicioni fillestar që zgjati nga mesi i muajit mars deri në mesin e majit, Avokati i Popullit u përshtat dhe funksionoi pa mbajtur takime fizike në person, dhe për rrjedhojë ishte më në gjendje për të adresuar numrin në rritje të kërkesave që mori në fillim të verës. Njëkohësisht, u realizuan fushata lidhur me aktivitetet e institucionit të Avokatit të Popullit. Drejt fundit të verës, stafi i institucionit filloi të kryente vizita në terren dhe të takonte qytetarët. Megjithëse në nevojë për paisje dhe infrastrukture online apo pavarisht se shumë qytetarë nuk kanë akses në internet, gjë që e ka vështirësuar mundësinë e tyre për t'iu drejtuar institucionit, prapëseprapë Avokati i Popullit ka arritur të dëshmoi qëndrueshmërinë e tij në plotësimin e mandatit për të mbrojtur të drejtat e njeriut.

Në të ardhmën, puna e Avokatit të Popullit pritet të rritet akoma më shumë ndërsa qytetarët kanë shqetësime në rritje lidhur me privacinë e aplikacionit Stop Corona (një aplikacion gjurmues); nënvlerësimi i situatave shëndetsore urgjente në këmbim të trajtimit të rasteve me Covid-19; apo edhe mbi qasjen e qeverisë mbi testimet.

- Të forcohen mekanizmat legjislativ për mbikqyrjen e buxhetit dhe financave. Të shqyrtohen me kujdes paketat ndihmëse të hartuara nga qeveritë në fazën e zbatimit, si dhe të monitorohet përdorimi i fondeve të donatorëve të jashtëm.

Afat gjatë

- Të vlerësohet si autoritetet dhe aktorët e mbikqyrjes mund të shfrytëzojnë besimin e krijuar të qytetarëve në politikanë dhe ekspertë të cilët kanë vepruar për të mirën e përbashkët në parandalimin e virusit. Thënë ndryshe: si të nxitet besimi në politikan dhe burokraci të bazuar nga e mira e përbashkët dhe jo nga interesat e ngushta klientaliste?
- Nga pikëpamja rajonale, Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut, mundësisht në bashkëveprim me vendet e tjera të rajonit, mund të marrin masa për mbylljen e kufijve dhe të bashkëpunojnë në parandalimin e përhapjes së virusit.
- Të përfshijnë mësimet e nxjera lidhur me mbikqyrjen demokratike dhe reformat në programet e hartuara rishtazi mbi integrimin europian (nepërmjet programit të para-anëtarësimit në rastin e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut dhe Marrëveshjes së Asocim Stabilizimit në rastin e Kosovës).

Përfundim

Reagimet ndaj masave të marra për të parandaluar përhapjen e Covid-19 kanë qënë të ngjashme në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Kur raste të virusit u shpallën në vendet e Ballkanit Perëndimor, disa shtete të europës perëndimore kishin një numër të lartë infektimes dhe numra të lartë të infektuarisht që ishin shtrirë në spital. Kjo bëri që të tria qeveritë përkatëse të nxirrnin mësimet dhe të nxitonin me marrjen e masave të ashpra kufizuese, përfshi edhe kufizimin me orare të lëvizjes, mbylljen e plotë dhe shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme. Norma e pranimit të masave nga qytetarët ishte e lartë në tre vendet pasi qytetarët ishin të vetëdijëshëm që shërbimi shëndetsor në vendët e tyre nuk ishte i aftë të përballonte me një nivel të lartë infektimesh.

Mbikqyrja demokratike e këtyre masave të ashpra kryesisht mungoi në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, sikurse edhe në shumë vende të tjera të botës. Kuvendet, institucionet e mbikqyrjes dhe organizatat e shoqërisë civile u përballen me probleme teknike gjatë kryerjes së roleve mbikqyrëse. Në fillimin e pandemisë, ka mbizotëruar dhe është pranuar përgjithësisht se ishte e nevojshme veprimi i përsheptuar pa kushtëzime nga ana e autoriteteve për të parandaluar përhapjen e virusit. Lehtësimi i masave kushtëzuese hapi mundësi të reja për debat dhe rritje të mbikqyrjes. Gjatëprocesit, Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut kanë mësuar që institucionet e ekzekutivit, legjislativit dhe gjyqësorit, bashkë me ato të shoqërisë civile, megjithëse të brishta, janë të qëndrueshme mjaftueshëm për tu përballur me probleme konkrete dhe për të ushtruar rolin e tyre mbikqyrës.

Në planin afatshkurtër, të treja vendet do duhet të marrin masa për të zhvendosur qeverisjen dhe mbikqyrjen online, por pa nënvlerësuar nevojën dhe mundësitë për të kryer punën në person kur të jetë e mundur. Në rafshin afatshkurtër, pas këtij testi mbi qeverisjen, është e nevojshme të reflektohet mbi çfarë ka shkuar mirë dhe çfarë ka nevojë për tu përmirësuar. Akoma më e rëndësishme është fakti që kërkohen angazhime konkrete për të përmirësuar llogaridhënien financiare të paketave ndihmëse të hartuara nga qeveria dhe ndihmës së donatorëve. Në planin afatgjatë, të trija vendet duhet të vazhdojnë të ndërtojnë demokracitë e tyre me vetëdijen që demokracia nuk kufizohet vetem me institucione dhe mekanizma, por që përfshin edhe frymë e sjellje. Respekti dhe reputacioni pozitiv i fituar nga disa politikan dhe zyrtarë të cilët kanë punuar për të mirën e përbashkët dhe sigurinë e qytetarëve në rrethana të vështira është dicka shëmbullore dhe një shenjë positive për të ardhmën.

Instituti për Studime Politike (ISP) është organizatë joqeveritare e cila operon në fushën e studimeve politike në Shqipëri. Fokusi i saj kryesor është monitorimi i proceseve politike të tranzicionit, aktivitetit të institucioneve politike dhe kushtetuese, edukimi publik përmes parimeve të transparencës, pjesëmarrjes, përfaqësimit dhe njohjes së koncepteve thelbësore të nevojshme për një demokraci funksionale.

Qendra Europiane për Studime të Sigurisë (CESS) është një institut kërkimi dhe trajnimi i pavarur me bazë në Groningen, Hollandë. CESS synon të avancojë sigurinë, zhvillimin, demokracinë dhe të drejtat e njeriut duke ndihmuar qeveritë dhe shoqëritë civile të përballen me sfidat përkatëse. CESS është një institut ndërkombëtar shumëdisiplinor dhe gjithëpërfshirës. Puna e CESS është pjesë e përpjekjeve për stabilitet dhe prosperitet si brënda ashtu edhe jashtë Europës. CESS nxit debatin e informuar, mirëkuptimin e përbashkët mbi çështje të qeverisjes, fuqizon individët dhe promovon proceset dhe strukturat demokratike.

DECOS

Projekti DECOS synon të fuqizojë institucionet demokratike dhe aktorët e shoqërisë civile në funksionin e tyre për të mbikqyrur sektorin e sigurisë. Këtë synon ta arrijë duke rritur kapacitetet, përmirësuar bashkëveprimin dhe duke nxitur kulturën e mbikqyrjes së sektorit të sigurisë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

Në projektin DECOS, Qëndren Europiane për Studime të Sigurisë (CESS) bashkëpunon me:

- *Institutin për Studime Politike (ISP)*, Shqipëri;
- *Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)*, Shqipëri;
- *Institutin për Kërkimin e Politikave dhe Zhvillimit (KIPRED)*, Kosovë;
- *Instituti për Demokraci 'Societas Civilis,'* Maqedoni e Veriut.

DECOS mbështetet financiarisht nga *Ministria e Punëve të Jashtme e Hollandës*. Pikëpamjet e shprehura nga autorët nuk reflektojnë domosdoshmërisht opinionin e sponsorit, CESS-it dhe ISP-së.

